

# RRUGA E PARTISË

ORGAN  
TEORIK DHE POLITIK  
I KOMITETIT QENDROR  
TË PARTISË SË PUNËS  
TË SHQIPËRISË

Adresa:  
«RRUGA E PARTISË»  
pranë KQ të PPSH – Tiranë

Pajtimet:  
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë  
Jashtë shtetit:  
për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

Mars 1982

Viti XXIX i botimit

## Përmbytja:

ENVER HOXHA — Vendosmëria e vullneti juaj janë shprehje e fyrnës së lartë revolucionare dhe e besimit tuaj të patundur në vijën e uizë të Partisë (Letra drejtuar kooperativës së tipit të lartë Hero i Punës Socialiste të Cakranit në rrëthim e Fierit).  
5

— Arritet e deritanishme në transformimin socialist të fshatit na kanë rritur entuziazmin dhe vendosmérinë për të marrë përsipër e për të realizuar objektiva më të mëdha (Letra drejtuar shokut Enver Hoxha nga kooperativistët e kooperativës së tipit të lartë Hero i Punës Socialiste të Cakranit në rrëthim e Fierit)  
7

### **PROBLEME TË KONGRESIT TË 8-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË**

RAMIZ ALIA — Rritja e cilësisë — detyrë themelore e letërsisë dhe e arteve (Fjala e mbajtur në plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, që zhvilloi punimet më 19-20 mars 1982)  
10

F. BABARAMO — Rritja e efektivitetit të ekonomisë — detyrë nga më kryesoret e pesëvjeçarit të shtatë  
25

SH. PRIZRENI — Mundësi të shumta për pakësimin dhe shfrytëzimin e dobishëm të mbetjeve teknologjike  
33

F. SALIÇAJ — Të trajtohen me të njëjtin shqetësim si problemet e realizimit të planeve ashutu dhe ato të kujdesit për punonjësit  
42

A.ÇARÇANI — «Revolucioni i gjelbër» — formë e kamufluar e shfrytëzimit neokolonialist  
50

### **BIBLIOGRAFI**

N. MYFTIU — Mësime të qmuara me vlera aktuale për revolucionarizimin e vazhdueshëm të organizatave të Partisë (Rreth vëllimit të 35-të të Veprave të shokut Enver Hoxha) 58

(Vijon në fagen prapa)

PËRVOJË NGA FUNA E PARTISE

S. BUSHATI — Realizimi i detyrave në ekonomi  
— objekt nga më kryesorët i punës së organi-  
zatave të Partisë

NGA VEPRIMTARIA  
E ORGANIZATAVE TË MASAVE

L. REXHA — Të rrisim më tej cilësinë e punës  
eduksive me riminë

VENDOSMËRIA E VULLNETI JUAJ JANË  
SHPREHJE E FRYMËS SË LARTË REVOLUCIONARE  
DHE E BESIMIT TUAJ TË PATUNDUR  
NË VIJËN E URTË TË PARTISË

KOOPERATIVISTËVE TË KOOPERATIVËS SË TIPIT TË LARTË  
HERO I PUNËS SOCIALISTE TË CAKRANIT

FIER

Të dashur shokë kooperativistë e kooperativiste, brigadierë, spe-  
cialistë e kuadro drejtues të kooperativës,

Më gëzoi shumë letra që më dërguat, me të cilën më njoftuat për  
arritjet tuaja gjatë vitit që kaloi, pse ato i shërbejnë fuqizimit të koo-  
perativës suaj dhe gjithë ekonomisë së Atdheut tonë e, në të njëjtën  
kohë, vërtetojnë drejtësinë e vijës së Partisë në zhvillimin socialist të  
fshatit. Më gëzoi gjithash tu zotimi juaj për t'i konsideruar këto arritje  
vetëm si hapat e para, vendosmëria e vullneti juaj për përparime akoma  
më të mëdha që do ta forcojnë më tej kooperativën e do t'ju  
bëjnë jetën më të begatë.

Kjo vendosmëri e ky vullnet janë shprehje e frysës së lartë re-  
volucionare që ju karakterizon dhe e besimit tuaj të patundur në vi-  
jën e urtë të Partisë. Jam i bindur se ju do t'i arrini objektivat e re-  
ja që i keni caktuar vetes. Këtë ju e keni vërtetuar me punën e pa-  
lodhur, me qartësinë e kuptimin e drejtë politik e ideologjik të dety-  
rave. Të jeni të sigurt se në çdo hap, si kurdoherë edhe në të ardhmen,  
do të keni mbështetjen e plotë të Partisë dhe ndihmën e pakursyer  
të pushtetit popullor. Ju dërgoj me këtë rast, në emër të Partisë, të  
Komitetit Qendror të saj dhe timin, përgëzimet më të mira për çka  
keni bërë dhe shpreh bindjen se do të ecni gjithnjë përpara e pa u  
ndalur në rrugën e drejtë që keni nisur.

Të dashur shokë e sheqe të Cakranit,

Kooperativa juaj bën pjesë në krahinën e bukur të Mallakastrës,  
ku jeton e punon një popull trim me tradita patriotike e revolucionar-

re, i lidhur që në fillim si mishi me thoin me Partinë, së cilës i ka qëndruar e i qëndron vazhdimisht besnik pa ia bërë asnjëherë fjalën dy. Blijtë e bijat e Mallakastrës, ashtu si të të gjithë Shqipërisë, luftuan heroikisht, shumë prej tyre dhanë jetën gjatë Luftës së madhe Nacionaleçlirimitare dhe sot nuk kursejnë asgjë për ndërtimin socialist dhe mbrojtjen e Atdheut.

Por Mallakastra nuk është vetëm një vatër e zjarritë patriotike e luftërave për liri, për dije e përparim, ajo është edhe një krahinë nga më pjelloret e Atdheut për prodhimin e drithërave, të bimëve industriale e rritjen e blegtorisë, një krahinë shumë e përshtatshme për frutikulturën dhe përmëm me vlera të mëdha të ullirit.

Ashtu si për të gjithë vendin, Partia ka pasë menduar e mendon edhe për zhvillimin ekonomik të Mallakastrës, për përmirësimin e jetës së popullit të saj trim e patriot në rrugën e socializmit. Përpajmet më këtë drejtim të gjithë i shohim me sytë tanë, ndërsa të mira e tij i gëzon vetë populli i kësaj krahine. Ballshi, nga një qytet i rrëgjuar e pa perspektivë zhvillimi në të kaluarën, është bërë sot një qendër e fuqishme e industrisë sonë të re socialist. Edhe fshatrat e Mallakastrës, gjithashtu, me transformimin socialist të bujqësisë, kanë ndryshuar si nata me ditën.

Partia është kujdesur vazhdimisht, edhe vetë personalisht jam interesuar dhe kam kërkuar që terreni i thyer i krahinës suaj të vihet më ujë dhe të kthehet sa më shpejt në bloqe të mëdhenj pemësh frutorë të të gjitha llojeve si dhe me ullinj, vreshta etj., kaq shumë të dobishme përmët ushqimin e njerëzve tanë dhe të nevojshme si lënde e parë për industrinë ushqimore.

Sot me kënaqësi konstatoj se nën kujdesin e vazhdueshëm të Komitetit Qendror të Partisë, të ndihmës së organizatës të Partisë e i pushtetit në rrith, si dhe të punës suaj të madhe, bujqësia e blegtoria, duke përfshirë edhe pemëtarinë tek ju, janë futur në rrugën e zhvillimit. Vazhdojeni këtë punë më me vrull në mënyrë që të çohet gjithnjë e më përpara zhvillimi ekonomiko-shoqëror si i kooperativës suaj, edhe ai i Mallakastrës, pse kjo është për të mirën tuaj, të mallakastriotëve dhe të të gjithë popullit e Atdheut tonë socialist.

Përfitoj nga ky rast përmët tju dërguar juve e nëpërmjet jush gjithë popullit punëtor, trim e patriot të Mallakastrës së Rapo e Dervish Hekalit, të Ramiz Aranitasit, të Dino Kalenjës e të sa e sa heronjve e dëshmorëve të tjerë, përhëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të miat, si dhe urimet më të mira në punë e në jetë.

Juaji  
ENVER HOXHA

Tiranë, më 24 mars 1982

**ARRITJET E DERITANISHME  
NË TRANSFORMIMIN SOCIALIST TË FSHATIT  
NA KANË RRITUR ENTUZIAZMIN DHE VENDOSMËRİNË  
PËR TË MARRË PËRSIPËR E PËR TË REALIZUAR  
OBJEKTIVA MË TË MËDHA**

**SHOKUT ENVER HOXHA  
SEKRETAR I PARË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH**

TIRANË

I dashur shoku Enver,

Ne, amëtarët e kooperativës bujqësore të tipit të lartë të Cakranit Hero i Punës Socialiste, në krahinë e Mallakastrës të rrithet të Fierit, me një ndjenjë të lartë krenarie për rezultatet e arritura analizuam përfundimet ekonomiko-financiare të vitit 1981.

Gjatë vitit që kaloi hodhëm një hap tjetër përpara në rrugën e intensifikimit të prodhimit bujqësor. Në kryjt sipërfaqen prej 950 ha të mbjellë me grurë morën 42,3 kv për ha. Sektori i Cakranit dhe ai i Gorishovës morën 48 kv për ha grurë. Brigadat pararojë që drejtohen nga Zakk Mihaj, Luftar Dalipaj etj., morën nga 52 deri 57 kv grurë për ha. Në misér, ku kemi fituar përvojë dhe kemi rritje të përvitshme të rendimenteve, morën 75 kv për ha në tërë sipërfaqen e mbjellë. Ne mbjellim 1000 ha me pambuk dhe në këtë bimë të rendësishme për ekominë tonë morën 13 kv për ha. Brigada të veganta, si ajo e 9-ta dhe e 6-ta në sekitorin e Varibopit, morën 26 dhe 24 kv për ha.

Ne kemi treguar kujdes për zhvillimin harmonik të të gjithë degëve të bujqësisë: bimëve të arave, blegtorisë, pemëtarisë e pyjeve. Gjatë këtyre viteve kemi dyfishuar numurin e kërave të lopëve dhe kemi rritur 2,5 herë prodhimin blegtoral. Kodrat e Cakranit, që i rrinë si kurorë fuishes së sistemuar e të begatë, janë veshur me 122000 rrënje ullinj, me 225 ha vreshta dhe me 90000 rrënje pemë frutore. Pemëtarja është bërë një sektor i fuqishëm dhe jep 13 përmët të ardhurave të kooperativës. Tokat e zëna me pemë e ullinj po shfrytëzohen intensivisht dhe nga

## *Letra e kooperativistëve të Cakranit*

ato sigurohen edhe foragjere të njoma e koncentrate, me të cilat ushqehen 8000 kërë bagëti të imta, 20000 gjela deti etj.

Zhvillimi i pandërpërë i prodhimit, sidomos gjatë këtyre 10 vjetëve të organizimit të Cakranit si kooperativë e tipit të lartë, ka siguruar rritjen e vazhdueshme të nivelit tonë të jetesës. Brenda kësaj periudhe më shumë se dy herë. Në këtë zonë, si në të gjithë Mallakastrën, jetojnë e ekonomisë sonë në përbashkët janë rritur të gjuar e të lumenj 15000 bamorë nga 3700 që kishin të nëntë fshatra e shtë bërë pothuajse krejtësisht i ri, me banesa të bukura e të mobiliuara me institucionë social-kulturore që plotësojnë më së miri nevojat tonë.

Këtë zhvillim të pakrashueshëm me të kaluarën, ne mallakastriotet si i gjithë populli ynë, ia dedikojmë udhëheqjes së drejtë marksiste-le-niniste të Partisë me Ju në krye i dashur shoku Enver. Populli i krahinës sonë, i lidhur si mishi me kockën me Partinë dhe me Ju, që në ditët e vënë jetë mësimet e Partisë dhe tuajat. Arrijet e deritanishme në transformimin socialist të fshatit, detyrat që shtroi Kongresi i 8-të i Partisë për intensifikimin e bujqësisë, na kanë rritur entuziazmin dhe vendosmërinë pér të marrë përsipër e pér të realizuar objektiva më të mëdha. Jemi të ndërgjegjshëm se ende kemi rezerva. Duke studiuar letër-këmbimet tuaja me kooperativistët e Dajçit dhe punëtorët e NB-së së Maliqit, duke u injohur konkretisht me përvojën e vyer të këtyre ekonomive dhe të ekonomive të tjera të dalluara, të gjithë ne, komunistë, kooperativistë dhe kuadro të kooperativës vendosëm që të avancojmë detyrat e pesëvjeçarit.

Duke marrë 80 kv pér ha misër, 20 kv pér ha fasule e sojë dhe 100 kv pér ha patate, qysh këtë vit realizojmë rendimentet e viti 1985. Në grurë do të marrim 44 kv pér ha, ndërsa më 1984 do të realizojmë rendimentin e vitit të fundit të pesëvjeçarit 46,2 kv pér ha në 900 ha me grurë. Në pambuk do të marrim 15,5 kv pér ha dhe objektivin e pesëvjeçarit do ta arrijmë në vitin 1983 duke marrë 18 kv pér ha në 1000 ha.

Zotimet tonë do t'i bëjmë realitet. Bazë pér këtë janë vija e drejtë marksiste-leministe e Partisë, mësimet tuaja i dashur shoku Enver, shtë puna e ndërgjegjshme e 4900 kooperativistëve, frysëzim shtë shembulli pararojë i 370 komunistëve të kooperativës sonë. Mobilizimit tonë gjithmonë në rritje po i përgjigjet organizimi dhe drejtimi më i mirë i punës së shtabet, të cilët funksionojnë gjatë gjithë kohës si shtabe lufte, ashtu siq na porositni Ju, shoku Enver.

Hapa të rëndësishme kemi bërë pér përqëndrim – specializimin e prodhimit. Brigadat e arave tanë kultivojnë nga dy kultura. Më mirë se çdo herë tjetër po zbatojmë teknologjitet e përparuara. Këtij qëllimi i shërbën puna e 1550 kooperativistëve që kanë kryer e vazhdojnë shkollën e mesme bujqësore. Kujdes po tregojmë që t'i kryejmë në kohë të gjitha punët e stinës. Gruri, në sajë të shërbimeve, paraqitet i mbarë. Jemi hedhur frontalisht pér përgatitjen e tokave dhe shtë pluguar 70 pér qind e sipërfaqes që do të mbillet me bimët e pranverës. Kemi rikonstruktuar gjithë rrjetin kullues e ujites, po vazhdojmë me shpejtësi dërgimin e plehet në arë, kemi siguruar farma të zgjedhura, të cilat lejojnë marrjen e

## *Letra e kooperativistëve të Cakranit*

rendimenteve të larta. Masa të mira kemi marrë e po marrim pér shtimin e bazës ushqimore, pér remontin dhe mbarështimin e bagëtive. Kemi vënë si detyrë që, në muajt prill-maj, të bëjmë 6000 tonë silazh pranveror, sa dyfishi i planifikuar duke siguruar më mirë nevojat e blegtorisë së kooperativës dhe ato të tufézuara. Pranverën e kemi kthyer në një betejë luturake pér të realizuar në kohë që detyrë.

I dashur shoku Enver,

Duke pasur në mendje e në zemër direktivat e Partisë dhe mësimet tuaja, do t'i cojmë më përparrë fitoret e arritura në zhvillimin e ekonomisë dhe në forcimin e mbrojtjes të Atdheut tonë socialist.

Të rrojë Partia jomë e lavdishme!

Të rromi sa malet tonë kreshnikë i dashur shoku Enver!

NGA KOOPERATIVISTËT E KOOPERATIVËS  
SË TIPIT TË LARTË HERO I PUNËS SOCIALISTE  
TË CAKRANIT, RRETHI I FIERIT

Cakran, më 14.3.1982